



Republika e Kosovës
Municipality of Istog
Republika Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Republic of Kosovo

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Istog shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialist i Administrimit të Përgjithshëm
Institucioni	Komuna Istog
Nr. i Referencës	RN00009239
Kodi	RPC0002982
Data e njoftimit	16.06.2022
Afati për aplikim	07.07.2022 - 14.07.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Udhëheqë programin e komunës lidhur me avansimin e të Drejtave të Fëmijëve, duke siguruar zbatimin e legjislacionit vendor;
2. Udhëheqë programet e komunës lidhur me të Drejtat e Fëmijëve duke siguruar zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut të aplikueshme në Kosovë;
3. Dizajnon dhe propozon politika reviduese në mënyrë që të arrihet përputhshmëria me standardet e Drejtave të Njeriut në fushën e të Drejtave të Fëmijëve;
4. Këshillon organet e komunës në zbatimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për të Drejtat e Fëmijëve;
5. Përfaqëson komunën në takimet që kanë të bëjnë me çështjet e të Drejtave të Fëmijëve ;
6. Inicon programet dhe projektet që do të përmirësojnë dhe promovojnë të Drejtat e Fëmijëve, në të gjitha fushat relevante duke bashkëpunuar në rrejtë me OJQ-të, komunat, organizatat e avokimit të Drejtave të Fëmijëve dhe ofruesit të shërbimeve për përmirësimin e kualitetit të jetës për fëmijët;
7. Bashkëpunon, me shkollat, institucionet parashkollore dhe institucionet tjera, me qëllim të mbrojtjes së drejtave të fëmijëve, po ashtu raporton edhe tek Zyrtari për të Drejta të Fëmijëve në Divizion për të Drejta të Fëmijëve në MAPL;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, drejtimet psikologji, sociologji , me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;
- Kualifikime të posaqme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;
- Pëvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punë, të fituar përmes arsimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vetë iniciativë në kuader të planeve dhe të procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0002843	RN00009093	Zyrtar për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim	Profesional 2	7	Komuna Istog	Drejtoria për Administratë Komunale / Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime (nga gjykata).

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Njohuri profesionale për fushën në të cilën zhvillohet konkurrimi;

Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave

Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

